

## NJË KËNDVËSHTRIM I RI PËR PENESTIAN DHE PENESTËT

Problemi i prejardhjes së dibranëve, i origjinës së tyre, ia vlen të hulumtohet edhe më thellë se deri tani, pasi gjurmë të tjera na shtyjnë të japim hipoteza të reja, por edhe të faktuara, ndonëse të panjohura deri më sot.

Emri i krahinës së Dibrës është nga më të njohurit, jo vetën në Shqipëri dhe në trojet shqipfolëse, por edhe në të gjithë diasporën e më tutje. Dibra dhe dibranët janë shquar që në shekujt e lashtësisë, si për besë e mikpritje, tipare të vërteta të personalitetit dhe kulturës, njëherësh edhe si luftëtarë për mbrojtjen e atdheut, duke u vënë gjoksin vështirësive për lirinë e trojeve amtare. Kësioj historia e Dibrës është e pasur dhe e begatshme.

Autori ka shfrytëzuar burimet historike për Ballkanin të shkruara përpara tij nga Aravantini, Ami Bue, Kanty Dezobri dhe Bashële, Farlati, Hammer-Purgstall, Hekard, Lavale, Le Bo, Lekyje, Parzo e Kais.

Sipas studimeve, historiani i vjetër Herodoti, në shek. V para erës sonë, është i pari që merret me Dibrën. Në hartën e Prolemeut, shek. II i erës sonë, shfaqet qyteti Deboros në tokën dibrane. Historianët, Ana Komnena dhe Kedoros, përmendin jo vetëm qytetin e Dibër, por edhe krahinën me të njëjtin emër. Është historia ajo që flet në mënyrë të pakundërshtueshme për lashtësinë dhe jep fakte e dokumente për etnitetin dhe progresin e saj.

Një “institutcion” i veçantë në Dibër ishte edhe oda dibrane, nga më të veçantat dhe më origjinalet.

*“Oda ka shërbyer si vendi ku thureshin e merrnin udhë këngët e bukura epike dhe lirike, ku festohej e gëzohesh, ku kumbonte kënga e niste gjëma, ku pritej e përcillej miku i shtëpisë, ku përdroeshin*

\* Prof. Dr. Arian Kadiu, “Mjeshtër i madh” Me propozim të kyetarit të Bashkisë së Peshkopisë, z. Ilir Krosi, Këshilli Bashkiak me vendimin unanëm të këshilltarëve dibranë, i dha në këtë veprimtari (100 – vjetori i Pavarësisë) Prof. Dr. Arian Kadiut, titullin “Nder i qytetit të Peshkopisë”, me këtë motivacion: “Për kontribut të çmuar e evidentues në fushën e studimeve si edhe të ngritjes lart të figurave kombëtare me prejardhje dibrane”. Peshkopi, më 22.11.2012. Veprimtaria u zhvillua në sallën e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

*fjalë të urta dhe dialogu alegorik...”.*

Në këto oda thureshin ëndrrat e bukura për të fituar lirinë e për t'i marrë zaptuesit tokat e trojet e të parëve, që kishin luftuar duke derdhur edhe gjakun e tyre. Në këto oda thureshin edhe plane, për t'u bashkuar dhe për t'i shporrur pushtuesit e ndryshëm.

Nëse do të shkoje atje, duhet të merrje doemos me vete (sigurisht sipas të folurit karakteristik të Dibrës, - pra, në mënyrë figurative -) një metër, një kandar dhe një thikë me dy presa. Metri që ta masje mirë fjalën përpara se të flisje, me kandar ta peshoje vlerën e asaj që do të thojë dhe duhet të shkoje me thikën me dy presa që kur të godisje dikë ta bëje provë më parë te vetja: nëse të dhimbte përpara se të “godisje” në mexhlis.<sup>1</sup> Në mexhlis merrnin pjesë edhe të rinj, edhe fëmijë. Ata vetëm dëgjonin dhe bënin shërbim. Kjo ishte edhe shkolla e vërtetë për këta të rinj që mësonin si të sillëshin, kur të bëheshin burra.

Për talentin dhe zotësinë e jashtëzakonshme të mjeshtëreve shqiptarë të Dibrës dhe të Ohrit bën fjalë J. G Hahn, i cili në “Albaniesisch Studien”, në vitin 1854, në faqen 43 thotë:

*“Këta ndërtimtarë të talentuar kanë punuar gati në të gjitha viset e Turqisë, Bullgarisë, Greqisë dhe të Serbisë”.*

Hahn vlerëson talentin e mjeshtëreve dibranë.

Autori tjetër D. Grabijan, në librin e tij citon shprehjen dibrane:

*“Nëse shkatërrohet Stambolli, Dibra do ta rindërtojë sërish, por nëse shkatërrohet Dibra, as Stambolli s'do ta përtërijë dot” f. 84.*

Grabijan përdor shprehjen e mësipërme dibrane.

Edhe studiuesi Shyqyri Nimani shkruan: “Arnavud.”<sup>2</sup>

Studiuesit e huaj dhe gërmimet e kërkimet tona në arkivat e pashfrytëzuara, duke paraqitur shkëlqimin dhe rënien e Perandorisë Romake, kanë analizuar edhe marshimin e barbarëve që ndikuan fuqishëm në rrënimin e perandorisë së fuqishme, sikurse ishin ardhjet e hunëve, ostrogotët, vizigotët etj. Ata erdhën nga Europa Qendrore, zbritën në Mesdhe dhe vërshuan në perëndim të Gadishullit të Ballkanit duke u përpjekur të nguliten aty.

Dibra ka dhënë kontribute të spikatura në dobi të çështjes kombëtare dhe të zhvillimeve historike të Shqipërisë, si për veprimtarinë atdhetare

1 Në mexhlis duhet të shkoje i përgatitur, nëse do të zije vendin që e meritoje dhe, mbase të takonte.

2 Artistët shqiptarë në Perandorinë Osmane”, Prizren, 2003.

të njerëzve të saj, si edhe për përpjekjet e ndihmesën e madhe në zgjimin e ndërgjegjes kombëtare. Kështu, Dibra ishte i vetmi qytet që e mbylli shekullin XIX me kuvende kombëtare dhe e nisi shekullin XX me kongrese kombëtare.<sup>3</sup>

Malet dhe fushat e Dibrës kanë qenë të populluara prej fisit të lashtë të penestëve. Në pragun e pushtimit romak, në truallin e penestëve, pra në krahinën e Dibrës, kishte 14 qyteza dhe kështjella. Më pas numri i tyre u shtua shumë.

Janë të shumtë autorët që kanë shkruar libra të plotë për Dibrën. Kështu, studiuesi Mehdi Frashëri shkruan një libër të plotë për Dibrën me titullin “Historia e lashtë e Shqipërisë dhe e shqiptarëve”, Tiranë, 2000.<sup>4</sup>

Në një ndarje me të shkon edhe Aleksandër Stipçeviq me materialin domethënës “Ilirët – historia, jeta, kultura, simbolet e kultit”.<sup>5</sup>

Po kështu kemi edhe studimin e shkrimtarit dibran Haki Stërmilli “Dibra në prag të historisë” Tiranë, 1940.<sup>6</sup>

Nga të gjitha burimet del se visigotët ishin barbarët e parë që mësynë Ballkanin dhe Ilirinë. Nga botimet e mësipërme del gjithashtu se gotët e Perëndimit vijnë në Ballkan në shekullin IV, kurse ata të Lindjes (ostrogotët) vijnë në shekullin V, pra të paktën i ndajnë mbi 50 vjet.

Një burim tjetër enciklopedik jep këtë të dhënë:

*“Në vitin 375 vërshoi papritmas nëpërmes Europës Lindore (hordhia e hunëve - A.K.) ... dhe i detyroi visigotët të kapërcenin Danubin për të kaluar në Perandorinë Romake.”<sup>7</sup>*

Studiues vendas dhe të huaj, për arsye të terrenit shumë të thyer e malor nuk kanë mundur të shkojnë në vend për ta njohur atë atje, në foletë ku “jeton” historia, ku kanë lindur, jetuar dhe vepruar aktorët dhe dëshmitarët e ngjarjeve tronditëse e të mëdha, por janë mjaftuar vetëm duke shkruar nga tryeza e punës. Kësisoj ata nuk kanë mundur t’i “zbulojnë” ngjarjet e lavdishme dhe t’i njohin heronjtë e saj.

Dibrës as i kanë munguar e as i mungojnë burrat e mençur. Jo pak janë bërë publikë, më pas vijnë të zotët në profesionin e tyre, të shquar në ushtrimin e armëve. Secili ia vlen të përmendet, por vështirësia qëndron këtu në atë, si t’i veçosh nga numri i madh disa prej tyre.

3 Prof. Dr. Arian Kadiu “Mjeshtëri i madh”, “Dibra e Madhe (Shehri i Dibrës)”, monografi, Tiranë, 2003, f. 3.

4 Mehdi Frashëri, “Një libër për historinë e Shqipërisë”.

5 A. Stipçeviq, Tiranë, 2002, f. 32.

6 Haki Stërmilli, 1940.

7 “. Paulyx Real: “Enciclopedie” vol. VIII (Dosja A I 85 - Arkivi i Institutit të Historisë).

Perëndia sikur e ka dalluar këtë trevë nga zonat e tjera. Ajo shtrihet në lartësinë mbi 350 metra mbi nivelin e detit. Lartësia 2751 metra bën që mali i Korabit, të bëhet i njohur si mali më i lartë i Ballkanit. Ky mal qëndron mbi të tjerët dhe është si babagjyshi i malave të tjera e të kreshtave ballkanike. Kurrizi i Korabit ndahet me tre masive kryesore, gropat e të cilit përbëjnë edhe pika takimi ndërmjet tyre. Ato kanë disa emra sinjifikativë sikurse janë: Kreshta e Panairit, e Staneve të Preshit dhe e Bjeshkës së Shehut.

Në shek.III,

*“...në kohën e Klaudit, perandorit romak nga Dardania, rreziku më i madh ishin gothët, të cilët ishin nisë me flotë të madhe nga brigjet e Detit të Zi, kishin debarkue afër malit Athos dhe ishin tue sulmue Selanikun. Klaudi u nis në krye t’ushtres për të dërmue anmikun. Ndënë udhëheqjen e tij guximtare e të shkathët, hordhitë barbare u shpartalluen pranë Naissus (nji qytet i Dardanisë ku qëndron Nishi i sotshëm)”*.<sup>8</sup>

Studiuesit vendas dhe të huaj, duke paraqitur shkëlqimin dhe rënien e Perandorisë Romake, kanë analizuar edhe marshimin e barbarëve që ndikuan fuqishëm në rrënimin e perandorisë së fuqishme, sikurse ishin ardhjet e hunëve, ostrogotëve, vizigotëve etj. Ata erdhën nga Europa Qendrore, zbritën në Mesdhe dhe vërshuan në perëndim të gadishullit të Ballkanit duke u përpjekur të nguliten aty.

Kështu, fiset gjermane që invaduan Perandorinë Romake në shekulli III njiheshin me emrin “goth”. Vendbanimi i tyre fillestar ishte Europa e Veriut, në mes të lumenjve Elbe dhe Oder, mbasi ishin një racë prolitike, (që shtoheshin shpejt), Kësisoj gotët kishin nevojë që të pushtonin toka të reja.

Krahina e Dibrës është një zonë që ka pasur peshën e saj të rëndë në historinë kombëtare dhe në shumë raste fjala dhe pushka e saj kanë qenë vendimmarrëse dhe vendimtare. Kjo nuk është krenari lokale apo krenari krahine. Pa mohuar rolin e trevave të tjera, Dibra e ka thënë kryefjalën dhe kryevendimin e saj, në momentet më kyçe e dramatike të lëvizjeve tona për liri e troje të përbashkëta. Nuk po hyj në histori, sepse do më duheshin vërtetë faqe e faqe pambarim për të ravijëzuar historinë e tyre.

Tit Livi na thotë për Perseun (lib.43, k.19) se penestët s’mund të ishin tjetër veçse dibranët, se Uskana duhet të gjendej në Dibër dhe, se

Oeneu duhet të gjendej drejt Lomit. I nisur nga Stubera për në Pelagoni, Perseu mbërrin për tri ditë në Uskanë, kryeqyteti i penestëve. Meqë, nga Stubera në Resnje, nuk duheshin as tri ditë, atëherë Uskana duhet të jetë në pellgun e Dibrave. Le të kthehemi në Ohër ose Lyhmid. Polibi dhe Straboni e cilësonin si qytet dhe mësojmë se rruga “Egnatia” ka kaluar aty. Duke qenë se Polibi kishte vdekur 122 vjet para Krishtit dhe Maqedonia u bë provincë romake në vitin 148 para Krishtit, atëherë duhet ta vendosin në këtë hapësirë kohore ndërtimin e rrugës “Egnatia” ose zgjatimin ilir të kësaj rruge ushtarake.<sup>9</sup>

Autori ka shfrytëzuar burimet historike për Ballkanin, të shkruara përpara tij nga Aravantini, Ami Bue, Kanty Dezobri dhe Bashële, Farlati, Hammer-Purgstall, Hekard, Lavale, Le Bo, Lekyje, Parzo e Kais.

Në librin e tij : “Historia e Shqipërisë” i Zhan Klod Faverial, i shkruar mes viteve 1884 dhe 1889, ai shkruan :

*“Në veri, shiheshin labeatët përreth Shkodrës, himanët drejt Tivarit e Ulqinit, taulantët në Muzaki dhe në lindje të Durrësit, partinët drejt Elbasanit dhe Tiranës, desaretët më lart në male, kanë për qytete kryesore Ohrin (Lyhnis) dhe Polionin (Bilisht), penestët në Dibrenë e Poshtme që kanë pasur Uskanën si qytet kryesor dhe pirustët prej Prizrenit deri në Prishtinë.*

*Shpeshherë perandorët dhe sundimtarët romakë për të shtypur kryengritjet e provincave kërkonin ndihmën e barbarëve. Kështu veproi perandori Honor me gotët e udhëhequr nga Alariku: në vitin 395 e.s. (shek.IV e.s), kur kishin ngritur krye taulantët dhe, duke mos qenë në gjendje të shtypte “kryengritjen e shtetasve të tij”, perandori dërgoi kundër ilirëve vizigotët që ishin futur aso kohë në Ballkan...Kufijtë veriorë e verilindorë që nga shek. III e këtej filluan të sulmoheshin gjithnjë e më shumë nga fise të ndryshme “barbare””.*

Në fillim të shekullit V, vizigotët (gotët e Perëndimit- A.K.), të cilët kishin qëndruar të qetë deri sa ishte gjallë Theodhosi, marshuan nëpër Thrakën e Maqedoninë, duke përparuar deri në muret e Kostandinopolit. Prijësi i tyre mbetej Alariku, i cili më vonë kapërceu në Itali dhe i rrethoi muret e Romës tri herë. Për të shpëtuar nga sulmet e tij, perandori i Lindjes, e emëroi komandant të ushtrisë në prefekturën e Ilirisë. Por Alariku shërbeu atje vetëm si oficer i Perandorisë Romake dhe nuk u instalua aty

9 Zhan Klod Faverial: “Historia e Shqipërisë (më e vjetër)” Tiranë, 2004.

me fiset e tij. Prandaj kjo fazë e invazioneve barbare nuk la ndonjë gjurmë të vazhdueshme në Shqipëri.

Bajraçet e Dibrës pavarësisht emërtimeve të veçanta kanë edhe një fakt domethënës: Dibra e Madhe (E sipërmja) nuk ka bërë asgjë pa Dibrën e Vogël (E poshtme). Këtu lipset të kuptohet se krerët e dy anëve të Dibrës (pashallarë, bejlerë, agallarë, pasanikë e të tjerë, kur bëhej fjalë për kombin dhe fatet e tij, luftëtarët zinin pozicion kundër pushtuesve dhe luftonin krah për krah njëri – tjetrit, derisa e shporrnin hasmin. Është fakt i pamohueshëm se për shumë ngjarje me rëndësi jetike kombëtare, nuk është marrë asnjë vendim ose zgjidhje pa u konsultuar me krerët e mençur e të urtë të dy Dibrave. Kjo bëri që të arrihej shkalla më e lartë për zgjimin e ndërgjegjes kombëtare në masën e popullit.

Në Dibër lëvizja kombëtare gjeti një zhvillim të ri dhe të rëndësishëm, kur në krye të saj u vu Sahit Islam Najdeni, mësuesi i njohur me emrin hoxhë Voka. Ai ishte një pjesëtar aktiv i Shoqërisë së Shkronjavë Shqipe të Stambollit, duke përfituar nga kontaktet e vazhdueshme që pati me patriotë të shquar të Rilindjes sonë, duke qenë edhe vetë një rilindas i njohur. Ai kishte lidhje me Naim e Sami Frashërin dhe Ismail Qemalin, dhe u bë propagandues i vendosur për përhapjen e shqipes së shkruar. Veprimtaria e tij nuk kufizohet vetëm në plan lokal, por edhe mbarëkombëtar. Kjo vërtetohet edhe nga vizitat e shpeshta që bënte në Kosovë, në lidhjet e vazhdueshme që mbante me Ismail Qemalin, i cili në vitin 1896 dërgoi dy herë nga Stambolli përfaqësuesin e vet për t'u takuar e biseduar në Dibër me të dhe me patriotin Dervish Hima.

Në shtypin e kohës, në këtë aspekt, vlerësohet gjendja e përparuar e Dibrës. Gazeta “Drita” e Sofjes, nr. 2, datë 17/30, vjeshtë e tretë, në vitin 1901, nën titullin “Paravajtje në Dibër” përshkruan në këtë mënyrë veprimtaritë arsimore e kulturore në krahinën e Dibrës:

*“Si ndë vise të tjera edhe këtu zuri me hy dashuri e mëmëdheut e bashkë me të edhe të gjuhës. Sot në Dibër të Madhe, ndë të Vogël, ndë Mat, Rekë e Malësi, kemi shumë zotni pleq të ndershëm që përpiqen për paravajtjen e gjuhës shqipe.. Sot i pasur, i varfër, i madh e i vogël thërrasin: Me gjuhë ruhet mënëdheu, me shkolla mirësohet kombi”.<sup>10</sup>*

Nga viti 1906, në Dibër të Madhe, u formua një komitet i fshehtë, veprimtaria e të cilit gjurmohej duke e ndjekur atë kudo. Reaksioni ishte i

10 Nga studimi monografik i Prof. Dr. Arian Kadiu, “Mjeshtër i madh” “Katër Kongrese Kombëtare për alfabetin e shqipes” f. 51 – 54.

fortë dhe komiteti u detyrua dhe e vrau mytesarifin, Hysni Beun. Në këto kushte, shqipja e shkruar mësohej gjerësisht në Dibër.<sup>11</sup>

Gjithë kjo valë e nxehtë diturie e shkollimi, ky shqetësim i popullit dhe i rinisë pati edhe domethënien e saj: organizimin e Kongresin Kombëtar për Alfabetin e Gjuhës Shqipe. Kongresi i parë u organizua dhe u çel në Manastir, më 14 – 22 nëntor 1908. Në të erdhën sipas marrëveshjes, 51 delegatë, dhe me votë të njohur ishin caktuar 31 përfaqësues të 23 klubeve, shoqërive dhe qyteteve. Merrnin pjesë drejtorë gazetash e letrarë, lëvrues të gjuhës e mësues të shqipes, militantë të njohur të lëvizjes kombëtare e të tjerë. Në këtë kongres u përfaqësuan, shoqëritë e ndryshme, klubet, si ai i Manastirit, Tiranës e Durrësit, Vlorës, Gjirokastrës e Beratit, Dibrës, Starovës, Leskovikut, Kolonjës, Shkupit, Selanikut, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të Bukureshtit e të Kostancës, të Sofjes, të Egjiptit, të arbëreshëve të Italisë pa dallim feje e krahine. Një manifestim i shkëlqyer i unitetit të popullit dhe i organizuar me përkrahjen e thuajse të gjithë dijetarëve shqiptarë.<sup>12</sup>

Por i tillë ishte edhe kongresi i dytë, ai i Dibrës, 24 – 28 korrik 1909. Delegati Qenan Manastiri, pjesëmarrës i drejtpërdrejtë i kongresit në Dibër, ka mbajtur shënime autentike nga kjo ngjarje e rrallë. Në këtë kongres, morën pjesë 320 përfaqësues (dhe jo 50-60 vetë) nga të pesë vilajetet, të përcaktuar nga 9 vetë për çdo vilajet, që të ishin të pranishëm në sallën e kongresit.<sup>13</sup>

Në shtëpitë mikpritëse dibrane, delegatët gjetën vatra të ndezura për lëvizjen kombëtare. Gjithë Dibërën, ndjenjat e flakta dhe etja për liri, e kishin kthyer në qendrën më të fuqishme atdhetare. Ky ishte edhe shkaku që pas kongresit, xhonturqit shpërthyen një terror të paparë,

Tezat e paraqitura e të trajtuara nuk janë hipoteza, ku faktet reale vërshonin si Drini, nga shumë atdhetarë e gazetarë, që e donin vendin e tyre, duke lartësuar edhe të qenit “shqiptarë”.

E sa për trimëri, dibranëve, si shqiptarë të vërtetë, rrallë ua kalonte njeri.

*“Për 20 e ca ditë që vazhdoi lufta, heroizmat e dibranëve janë të papërshkrueshme. Në raste të tilla njeriu s’kursen as jetën për të mbrojtur vendin e vet.*

11 Për këtë shkruan gazeta “Pellazgu” e Kajros, nr. 2, 15 mars, 1907, nën titullin “Pun e Dibrës”: “Dibranët kanë çelë synë e qëllon kanë me lyp gjuhën e tyre e mësojtore shqip”.

12 Shih. A. Kadiu :“Katër Kongrese Kombëtare për alfabetin e shqipes” (Refleksione dhe thellime) f. 5 – 49.

13 “Kongresi i Dytë i Dibrës 24 – 28 korrik 1909. Dashakeqësia e elementëve negativë” f. 49 – 120.

## Ja edhe një këngë për luftën:

*“Ditë e diel, ditë pazari  
emën ban komandari,  
komandari i biri i shkinës  
s’i ka njoftun djemt’ e Dibrës  
djemt’ e Dibrës, djemt’ e malit,  
që ta plasin kapakn’ e ballit ...”<sup>14</sup>  
Më poshtë disa vargje të një këngë popullore (e njohur):  
“Po i çon Shkodra Dibrës fjalë”  
“Po i çon Shkodra Dibrës fjalë  
A ma fal për luft’ ni djal’  
Se më ka ndodhun ni rrezik  
M’ka hi shkjau në Koplík.  
Dibra e Mati n’kam jan’ çu  
Gjall Shkodrën mos me e lshu  
Prit - prit Shkodra nan’  
T’kam fal cull e t’kam fal djal’”.<sup>15</sup>*

Nisur nga të gjitha këto, rrjedhimisht, kam të drejtë, të parashtoj tezën se në fund të shekullit IV dhe në fillim të shekullit V, te penestët erdhi e “pftuar” një popullsi tjetër, ostrogotët, të cilët iu nënshtruan zakoneve vendase dhe, ndoshta pa u asimiluar prej tyre, bashkëjetuan me ta. Pjesë - pjesë një numër i papërcaktuar i tyre, kaloi në Itali. Kësisoj, në të gjithë Dibrën, si në përfundim edhe në veri të saj (në kufi me pirustët, ardianët dhe dardanët) u krijua një popullsi penesto-gote. Këtë e dëshmon edhe fakti se në të dy Dibrat, bashkë me rrethinat, ka mjaft familje që për shkaqe të ndryshme familjare (disa thonë se që nga koha e Skënderbeut) kanë ardhur aty te fiset përkatëse, me të njëjtin mbiemër. Ata janë vendosur në trojet dibrane, në përfundim dhe në veri të Dibrës.

Këto dukuri me përmbajtje historike vërtetojnë se në fund të shek. IV dhe në fillim të shek. V, te penestët erdhi edhe një popullsi tjetër.

Mbase, burimi më i besueshëm, është shkëputur nga një botim në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Teksti dhe harta e botuar në faqen 182, kanë këtë përmbajtje, e cila thotë :

*“Historia e thotë fjalën e saj. Rrjedhimisht nga fundi i shekullit*

14 Sejfi Vllamasi: “Ballafaqimet politike në Shqipëri” 1897-1942. Tiranë, 1995.

15 Shënim: Në materialet e paraqitura është ruajtur dialekti i historianit të cituar që përkthen dhe sqaron.

*IV dhe fillimi i shekullit V visigotët (gotët e Perëndimit – A.K.) zbritën nga veriu i Europës, kaluan stepat ruse dhe erdhën në Konstandinopojë, Greqi dhe Shqipëri etj”.*<sup>16</sup>

## Një shënim i nevojshëm:

Nga Robert Elisie **“FISSET SHQIPTARE”**, Prishtinë, 2007

Për çdo studiues, ka njerëz të caktuar me shkollim të cekët në zona të ndryshme, të cilët bëhen garant se e njohin historinë e Dibrës dhe të X zone dhe do t'i orientojnë ata në ato vise për të cilat ata interesohen. Drejtimi nga ata është i garantuar, se X person i ka marrë në besë. Ai person mund të jetë nga Veriu, ose nga Jugu, madje ishte edhe i sigurtë se po i ndihmonte historianit që interesohej për fise dhe kuriozitetet të ndryshme, me “vlerë” historike. Njihuni me saktësinë e këtyre njerëzve që marrin mbi vete “barrë” të rënda, që shpatullat e rrëfyeshve nuk mund t'i mbajnë. Rrëfyeshit, mbase shpërblehen, por shoqëruesi mund t'i përmendë edhe emrin e tij në librin e vet.

Pasi jep një mori datash, autori R. Elisie ka dalë në përfundimin se fisi i Dibrës, në të vërtetë është një grup gjeografik i disa fiseve më të vogla në luginën e Drinit të Zi. Fiset gjenden kryesisht në anën e majtë të lumit.

Në fund paraqiten edhe legjenda për fisin, stërgjyshërit dhe historira të tjera. Figura të shquara janë radhitur, si Skënderbeu, Elez Isufi, Fiqiri Daci. Me këto të dhëna mbyllet Dibra, që për çdo herë djemtë e burrat e saj kanë bërë histori kombëtare dhe janë gjendur në ballë të saj.

Në Shqipëri nuk janë të rrallë historianët që vijnë të paraqesin zbulimet që arrijnë të “deshifrojnë” nga historia jonë e vlefshme. Këtyre studiuesve të zellshëm u ofrohen diletantë, që vijnë me rekomandime të dikujt që banon në shtetin nga vijnë ata. Do të ishte me vlerë ngritja e një sektori të vogël, më e shumta me punonjës të Akademisë së Shkencave, që merren me bibliotekën. Këta mund të jenë udhërrëfyes të çmuar për ata të huaj që punojnë me zell dhe mund t'u rekomandojnë emra që me të vërtetë mund t'i ndihmojnë këta të ardhur nga përtej deteve e maleve për studime të vërteta.<sup>17</sup>

*“Ka një fakt domethënës, që e veçon historinë e krahinës së Dibrës,*

16 Scott Foresman: “History and Life” (Historia dhe jeta), 1993, Illinois USA.

17 Robert Elisie “Fiset shqiptare”, Prishtinë, 2007.

*duke vënë në dukje edhe vetitë e cilësitë e dalluara që ajo ka. Kur bëhej fjalë për qëndresën në trojet e të parëve, arma e dibranit është dëgjuar në çdo cep të Shqipërisë. A ka ndonjë qytet tjetër ku dibranët luftuan për mbrojtjen e tij? Sigurisht që ka. Po më tipiku është ai i Shkodrës. Po sjell dy fakte:*

*Për 20 e ca ditë që vazhdoi lufta malezezo – shqiptare për*

*mbrojtjen e Shkodrës, heroizmat e dibranëve qenë të papërshkrueshme. Në raste të tilla njeriu nuk kursen as jetën për të mbrojtur vendin e vet. Këtë heroizëm e përshkruan bukur gazetari italian Gino Berri, në librin e tij shkruar enkas për këtë ngjarje, ku ka qenë dëshmitar.*

*Shkodra është një qytet që ka një lagje që thirret “Mëhalla e dibranëve” dhe jo pak familje të nderuara mbajnë mbiemrin “Dibra”. Në këtë qytet kanë varret e tyre dëshmorët dibranë që u vranë në këtë luftë”.*

*”Dibranët kanë marrë pjesë edhe në Luftën e Vlorës, në vitin 1920 dhe se kryetari i Pleqësisë së Qeverisë së Ismail Qemalit, ishte dibran - Vehbi Dibra, Agolli, kurse një dibran tjetër, Nikollë Kaçorri, ishte nënkryetar i po kësaj qeverie”.*

### **Bibliografia**

1. Studiuesi i njohur J. G Hahn, në “Albaniesisch Studim”, në vitin 1854, në faqen 43, thotë: “Këta ndërtimtarë të talentuar kanë punuar gati në të gjitha viset e Turqisë, Bullgarisë, Greqisë dhe të Serbisë”.
2. D. Grabijan, në një nga librat e tij citon shprehjen dibrane: “Nëse shkatërrohet Stambolli, Dibra do ta rindërtojë sërish, por nëse shkatërrohet Dibra, as Stambolli s’do ta përtërijë dot”, f. 84.
3. Shyqyri Nimani: “Arnavud. Artistët shqiptarë në Perandorinë Osmane”, Prizren, 2003.
4. Prof. Dr. Arian Kadiu “Dibra e Madhe” (Shehri i Dibrës), monografi, Tiranë 2003, f. 3.
5. Prof. Dr. Arian Kadiu “Mjeshtëri i madh”, “Dibra e Madhe”

- (Shehri i Dibrës), monografi, Tiranë 2003, f. 3.
6. Mehdi Frashëri, “Një libër për historinë e Shqipërisë”.
  7. A Stipçeviq me materialin domethënës “Ilirët – historia, jeta, kultura, simbolet e kultit”, Tiranë 2002, f. 32.
  8. Haki Stërmilli: “Dibra në prag të historisë”, Tiranë, 1940.
  9. Paulyx Real: “Enciclopedie” vol. VIII (Dosja A I 85 - Arkivi i Institutit të Historisë).
  10. Tajar Zavalani : “Histori e Shqipnis” (botimi i dytë) Tiranë, 1998, f. 63.
  11. Zhan Klod Faveirial: “Historia e Shqipërisë (më e vjetër)” Tiranë, 2004.
  12. Nga studimi monografik i Prof. Dr. Arian Kadiu, “Mjeshtër i madh”, “Katër Kongrese Kombëtare për alfabetin e shqipes” f. 51 – 54.
  13. Kongresi i Dytë i Dibrës 24 – 28 korrik 1909. Dashakeqësia e elementëve negativë f. 49 - 120
  14. Sejfi Vllamasi: “Ballafaqimet politike në Shqipëri” 1897-1942, Tiranë 1995.
  15. Scott Foresman: “History and Life” (Historia dhe jeta), 1993, Illinois, USA.
  16. Robert Elisie “Fiset shqiptare”, Prishtinë, 2007.
  17. Arian Kadiu ”Katër Kongrese Kombëtare për alfabetin e shqipes”, f. 118 -119.